



# MEDREG

U zhvillua sot nëpërmjet platformës online, Mbledhja nr. 41 e Komitetit Drejtues së MEDREG, në të cilën mori pjesë dhe e kryesoi Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë, z. Petrit Ahmeti, në rolin e Presidentit të MEDREG.

Në këtë mbledhje, Drejtuesit e Grupeve teknike të punës (GP) raportuan mbi rezultatet kryesore që do të dorëzohen. Ata gjithashtu sollën në kujtesë aktivitetet e tjera (mbështetja për reformat kombëtare, Seminaret) që ata kanë planifikuar gjatë vitit.

Presidenti i MEDREG, z. Ahmeti po ashtu reflektoi mbi performancën e Grupeve të punës, paçka një viti kompleks, si dhe nënvijëzoi rëndësinë e programimit me kujdes të pjesës tjetër të vitit, në mënyrë që MEDREG të mund të kryejë me sukses, në një mënyrë të qëndrueshme dhe me një organizim të ekuilibruar, aktivitetet e parashikuara në kontratën e grantit.

Lidhur me mbështetjen e Presidences për GP, Presidenti theksoi se qëllimi i propozimit nuk është të veprojë si mbikëqyrës i Drejtuesit të GP, por si një lehtësues për të përfutur kontakte të nivelit të lartë dhe t'i japë më shumë vizibilitet punës së bërë, si dhe prezantimi i aspekteve kryesore të politikës në diskutimet e GP. Ai nënvijëzoi se qëllimi i këtij dokumenti është të diskutojë hapur çështjen me Drejtuesit dhe të sigurojë që zgjedhja për të caktuar një anëtar të Bordit për secilën GP bëhet në bashkëpunim të plotë me anëtarët e SC. Presidenti ftoji anëtarët e Bordit të shpjegojnë vlerën e shtuar që ata dëshirojnë të sjellin në GP dhe të shprehin përparësitë dhe nevojat e tyre në lidhje me aktivitetet e GP në mënyrë që anëtarët e Presidencës të sigurojnë mbështetje të hollësishme.